



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR**

**VENDIM**  
**Nr. 335, datë 18.09.2020**

**PËR**  
**CAKTIMIN E GJYQTARËVE PËR GJYKIMIN E ÇËSHTJEVE GJYQËSORE TË**  
**VEÇANTA NË GJYKATA TË TJERA, TË NDRYSHME NGA AJO KU USHTROJNË**  
**FUNKSIONET NË MËNYRË TË PËRHERSHME**

Këshilli i Lartë Gjyqësor bazuar në nenet 4/3, 147/1, 147/a, pika 1 germa “a” të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenet 2 e 89 të ligjit nr.115/2019 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” në vendimin nr.30, datë 14.02.2019 të Këshillit të Lartë të Gjyqësor që miratoi projektvendimin “Për rregullat dhe procedurat e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme” i ndryshuar, në rastet kur skema e delegimit dhe transferimi i përkohshëm janë të pamjaftueshme për t’iu përgjigjur nevojave aktuale të gjykatave, pasi shqyrtoi relacionin dhe propozimin e Komisionit për Zhvillimin e Karrierës si dhe organizoi shortin, në përfundim të tij,

**VENDOSI:**

I. Të caktojë gjyqtarët për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykatat në nevojë si vijon:

**GJYKATA E APELIT GJIROKASTËR**

1. Gjyqtari i Gjykatës së Apelit Vlorë, Sokol Ngresi, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Gjirokastër, çështjen penale në ngarkim të të pandehurit: {...}; Akuza: “Dhunë në familje”.

**GJYKATA E APELIT SHKODËR**

1. Gjyqtari i Gjykatës së Apelit Durrës, Izet Dushaj, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Shkodër, çështjen penale në ngarkim të të pandehurit: {...}; Akuza: “Nenet 88/1-25, 278/1 të Kodit Penal”.

2. Gjyqtari i Gjykatës së Apelit Durrës, Desart Avdulaj, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Shkodër, çështjen penale në ngarkim të të pandehurit: {...}; Akuza: “Neni 283 i Kodit Penal”.

3. Gjyqtari i Gjykatës së Apelit Durrës, Desart Avdulaj, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Shkodër, çështjen penale në ngarkim të të pandehurës: {...}; Akuza: “Neni 248 i Kodit Penal”.

4. Gjyqtari i Gjykatës së Apelit Durrës, Izet Dushaj, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Shkodër, çështjen gjyqësore me kërkues: {...}; Objekti: “Përrjashtim gjyqtari”.

5. Gjyqtari i Gjykatës së Apelit Durrës, Izet Dushaj, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Shkodër, çështjen gjyqësore me kërkuese: “{...}”; Objekti: “Përrjashtim gjyqtari”.

### **GJYKATA E APELIT VLORË**

1. Gjyqtari i Gjykatës së Apelit Gjirokastrë, Enton Dhimitri, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Vlorë, çështjen gjyqësore me kërkuese: {...}; Objekti: “Fshirjen e dokumentave të konstatuara të falsifikuara nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Lushnje me vendimin e datës 27.05.2016 të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Lushnje”.

2. Gjyqtarët e Gjykatës së Apelit Gjirokastrë, Izet Salaj dhe Dritan Banushi, caktohen në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Vlorë, çështjen gjyqësore me ankues: {...}; kundër: Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Fier; Objekti: “Ankim kundër vendimit të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Fier të datës 30.04.2018 “Për mosfillimin e procedimit penal për kallëzimin nr.727, datë 25.04.2018”.

3. Gjyqtarët e Gjykatës së Apelit Gjirokastrë, Irena Brahimi dhe Izet Salaj, caktohen në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Vlorë, çështjen gjyqësore me kërkuese: {...}; persona të interesuar: {...}; Objekti: “Sigurim padie”.

### **GJYKATA E POSACME E SHKALLËS SË PARË PËR KORRUPSIONIN DHE KRIMIN E ORGANIZUAR**

1. Gjyqtarja e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë, Alma Kolgjoka (relatore), gjyqtari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, Rexhep Bektoshi si dhe gjyqtarja e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë, Ornela Naqellari, caktohen në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, çështjen gjyqësore me kërkuese: Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar; I pandehur: {...}; Akuza: “Nenet 140, 333/a/2, 334/1 të Kodit Penal”.

2. Gjyqtarja e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, Manjola Xhaxho (relatore), gjyqtarja e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pogradec, Emona Muçi si dhe gjyqtarja e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnje, Esmeralda Xhili, caktohen në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, çështjen gjyqësore me kërkuese: Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar; të pandehur: {...}, {...}, {...}dhe {...}; Akuza: “Nenet 283/a/1, 28/4, 333/a/2, 334/1 të Kodit Penal”.

II. Një kopje e vendimit t’i njoftohet kryetarit të gjykatës në nevojë dhe gjyqtarëve përkatës të caktuar për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në një gjykatë tjetër.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë me publikimin e tij në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

**PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR  
KRYETARE**